

UDHËZIM
Nr. 16, datë 12.10.2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 18.1.2012 “PËR
DOKUMENTET E QARKULLIMIT DHE REGJISTRIMIT TË MJETEVE RRUGORE ME
MOTOR DHE RIMORKIOVE TË TYRE”**

Në mbështetje të pikës 4, neni 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 92-102 dhe 220-224 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe neneve 237-252, 368 dhe 370 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 “Rregullorja e Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

Neni 1

1. Në nenin 3 pika 2, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:
“d) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS).”
2. Në nenin 3 pika 4, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:
“d) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS).”
3. Në nenin 3, pas pikës 4 shtohet një pikë 4.1 me këtë përmbajtje:
“4.1 Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e përdorura, të shitura me ankand nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, por të paregjistruara në Shqipëri.
 - a) Dokumenti i fitimit të pronësisë, që në këtë rast nënkupton vendimin e gjykatës ose të organit të ngarkuar me ligj, me anë të të cilit mjeti kalon në pronësi të institucioneve të lartpërmendura.
 - b) Faturën e shitjes me TVSH, të lëshuar nga institucionet e mësipërme (në origjinal) ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njëzuar me origjinalin).
 - c) Fotokopjen e njëzuar me origjinalin të procesverbalit mbi gjendjen fizike të mjetit në momentin e shitjes, në të cilin përveç të tjerave të evidentohet numri i identifikimit të mjetit dhe sipas rastit mungesa e dokumenteve teknike shoqëruese të mjetit dhe mungesa e targave.
 - d) Dokumenti i zhdoganimit nga autoriteti shqiptar, si në pikën 1 shkronja “c” të këtij neni.”.

Neni 2

1. Në nenin 7 pika 1, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:
“f) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS), sipas rasteve të përcaktuara në nenin 3 të këtij udhëzimi.”.
2. Në nenin 7, pas pikës 1 shtohet një pikë tjetër 1.1, me këtë përmbajtje:
“1.1. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e përdorura, të shitura me ankand nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, është i njëjtë me atë të përcaktuar në nenin 3 pika 4.1 të këtij udhëzimi.”.

Neni 3

1. Në nenin 13, pas pikës 1 shtohet një pikë 1.1 me këtë përmbajtje:
“1.1 Për mjetet e regjistruara në Arkivin Kombëtar të Mjeteve, që shiten me ankand nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1, personi i interesuar dorëzon edhe këto dokumente:
 - a) Dokumenti i fitimit të pronësisë, që në këtë rast nënkupton vendimin e gjykatës ose të organit të ngarkuar me ligj, me anë të të cilit mjeti kalon në pronësi të institucioneve të lartpërmendura.

b) Faturën e shitjes me TVSH, të lëshuar nga institucionet e mësipërme (në origjinal) ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njëzuar me origjinalin).

c) Fotokopjen e njëzuar me origjinalin të procesverbalit mbi gjendjen fizike të mjetit në momentin e shitjes, në të cilin, përveç të tjerave, të evidentohet numri i identifikimit të mjetit dhe sipas rastit, mungesa e dokumenteve teknike shoqëruese të mjetit dhe mungesa e targave.”.

Neni 4

1. Në nenin 21 pika 2, shkronja “f” ndryshon me këtë përmbajtje:

“f) Dokumenti i fitimit të pronësisë, kur ka ndryshim pronësie.”.

2. Në nenin 21 pika 2, pas shkronjës “g” shtohet shkronja “h” me këtë përmbajtje:

“h) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS)”.

3. Në nenin 21 pika 4, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

“f) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS)”.

Neni 5

1. Në nenin 23 pika 2, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS)”.

2. Në nenin 23 pika 4, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS)”.

3. Në nenin 23, pas pikës 4 shtohet një pikë 4.1 me këtë përmbajtje:

“4.1 Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e përdorura, të shitura me ankand nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, por të paregjistruara në Shqipëri.

d) Dokumenti i fitimit të pronësisë, që në këtë rast nënkupton vendimin e gjykatës ose të organit të ngarkuar me ligj, me anë të të cilit mjeti kalon në pronësi të institucioneve të lartpërmendura.

e) Faturën e shitjes me TVSH, të lëshuar nga institucionet e mësipërme (në origjinal) ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njëzuar me origjinalin).

f) Fotokopjen e njëzuar me origjinalin të procesverbalit mbi gjendjen fizike të mjetit në momentin e shitjes, në të cilin, përveç të tjerave, të evidentohet numri i identifikimit të mjetit dhe sipas rastit, mungesa e dokumenteve teknike shoqëruese të mjetit dhe mungesa e targave”.

g) Dokumenti i zhdoganimit nga autoriteti shqiptar, si në pikën 1 shkronja “c” të këtij neni”.

Neni 6

1. Në nenin 26 pika 1, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS)”.

2. Në nenin 26, pas pikës 1 shtohet një pikë 1.1 me këtë përmbajtje:

“1.1 Për mjetet e regjistruara në Arkivin Kombëtar të Mjeteve, që shiten me ankand nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1, personi i interesuar dorëzon edhe këto dokumente:

a) Dokumenti i fitimit të pronësisë, që në këtë rast nënkupton vendimin e gjykatës ose të organit të ngarkuar me ligj, me anë të të cilit mjeti kalon në pronësi të institucioneve të lartpërmendura.

b) Faturën e shitjes me TVSH, të lëshuar nga institucionet e mësipërme (në origjinal) ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njëzuar me origjinalin).

c) Fotokopjen e njëzuar me origjinalin të procesverbalit mbi gjendjen fizike të mjetit në momentin e shitjes, në të cilin, përveç të tjerave, të evidentohet numri i identifikimit të mjetit dhe sipas rastit

mungesa e dokumenteve teknike shoqëruese të mjetit dhe mungesa e targave.”.

Neni 7

1. Në nenin 29 pika 1, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:
“d) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS).”

Neni 8

1. Në nenin 36 pika 1, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:
“d) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS).”

Neni 9

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi